



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Data: 12.5.2023

Nr: 505

Ora: 15:00

VENDIM

PËR

**LIRIM DHE EMËRIM TË SEKRETARIT TË KZAZ NR. 24, BASHKIA DURRËS, PËR ZGJEDHJET PËR
ORGANET E QEVERISJES VENDORE TË DATËS 14 MAJ 2023**

Në mbështetje të nenit 19, pikat 1, shkronja “ç”, dhe 2, nenit 32, pika 2, shkronja “d”, të ligjit nr.10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve,

V Ë R E N:

Në bazë të nenit 32, pika 2, shkronja “d”, të Kodit Zgjedhor, Partia Demokratike e Shqipërisë, me shkresën nr. 5044 prot., datë 12.5.2023, ka kërkuar:

-Lirim nga detyra të sekretarit znj. Brunilda Kalaja dhe emërimin e z. Devis Met-Hasani.

Propozimet dhe kandidaturat e paraqitura, plotësojnë kriteret e përcaktuara në nenet 30, 31, dhe 32, pika 2, shkronja “d”, të Kodit Zgjedhor.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenin 19, pikat 1, shkronja “ç”, dhe 2, nenet 30, 31, dhe 32, pika 2, shkronja “d”, të ligjit nr.10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

Data: 12.5.2023 Nr: 505
Ora: 15:00



“Për lirim dhe emërim të sekretarit të KZAZ-së nr.24, Bashkia Durrës, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023”.

V E N D O S:

1. Lirimin nga detyra të sekretarit të KZAZ-së nr. 24 , znj. Brunilda Kalaja, Bashkia Durrës.
2. Emërimin e sekretarit të KZAZ-së nr. 24, z. Devis Met-Hasani, Bashkia Durrës.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë, publikohet në faqen elektronike zyrtare të KQZ-së dhe i njoftohet KZAZ-së përkatëse.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve, brenda 3 (tre) ditëve nga shpallja e tij.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI